

FREQUENT

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



“KUJDES”

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

Herbicid selektiv sistemik per luftimin e barerave te keqija graminore nje dhe shumevjecare ne kulturat bujqesore gjethegjera.

Përmbajtja: *Fluazifop-P-butyl 125 g / l.*

Formulimi: *Koncentrat i Emulsionueshem. (EC).*

Masat parambrojtëse:

P202 - Mos trajtoni derisa të gjitha masat paraprake të sigurisë të jenë lexuar dhe kuptuar.

P280 - Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/syze mbrojtëse/mbrojtëse të fytyrës.

P301 + P310 Nese gëlltitet: Thirrni menjëherë një mjek.

P331 - Mos shkaktoni të vjella.

P302 + P352 - Ne rast kontakti me lekuren: Lani me shumë ujë.

P391 - Mblidhni derdhjen.

P501 - Hidhni ambalazhin në pikën e grumbullimit të mbeturinave të rrezikshme ose të veçanta, në përputhje me rregulloren me ligjet ne fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

H304 - Mund të jetë fatale nëse gëlltitet dhe hyn në rrugët e frymëmarrjes

H317 - Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës

H361d - Dyshohet të dëmtojë fëmijën e palindur (fetusin)

H410 - Shumë toksik për jetën ujore me efekte të gjata.

EUH066 - Ekspozimi i përsëritur mund të shkaktojë tharje të lëkurës ose plasaritje.

EUH401 - Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, respektoni udhëzimet e përdorimit.

Masat e ndihmës së parë: Nëse nuk ndiheni mirë kërkoni menjëherë këshillë mjekësore (tregoni etiketën kur është e mundur). Në rast aksidenti, telefononi urgjensën mjekësore.

Përdorimi:

Lufton barerat e keqija graminore nje dhe shumevjecare pas mbirjes se tyre si: muhari, talla, grami, krisja e ujit, kastreva, meli i pergjakur, egjrat, tershera e eger tek vreshti, ulliri, agrumet, pemet frutore dhe tek kulturat gjethegjera te perimeve dhe bimeve te arave.

Eshte herbicid sistemik dhe perdoret pas mbirjes. Pas sperkatjes, thithet nga gjethet, leviz shpejt nepermjet floemes e ksilemes dhe akumulohet ne meristemat e pjeseve mbitokesore dhe nentokesore te barerave te keqija.

Perdoret ne vreshta, ullishte, peme frutore, agrume, perime (kulturat gjethegjera), bimet e arave (kulturat gjethegjera), koles, pampuk, panxharsheqeri, luledielli, patate, fasule, qepe, soje, duhan, terfil, fidanishte, bime zbukuruese kunder barerave te keqija graminore njevjecare me dozen 2 L/ha, duke perdorur 300-500 lit solucion per hektar.

Ndersa per barerat e keqija graminore shumevjecare, perdoret ne dozen 3 L/ha.

Per barerat e keqija njevjecare perdoret ne fazen e 1-3 gjetheve, dhe per barerat e keqija shumevjecare kur ndodhen ne rritjen intensive deri para lulezimit te tyre. Eshte mire qe per barerat e keqija shumevjecare te behet copetimi i tyre me ane te punimit perpara sperkatjes.

Kur mbirja e barerave te keqija zgjat per shume kohe eshte me mire qe te behen dy sperkatje (duke perdorur ne secilen ½ e dozes se rekomanduar ne interval nje mujor).

Simptomat qe shkaktohen tek barerat e keqija pas trajtimit me FREQUENT jane: Pas trajtimit barerat e keqija graminore ndalojne rritjen dhe zhvillimin. Gjethet me te reja marrin ngjyre te verdhe ose te verdhe ne te kuqe. Nje ose dy jave me vone, rizomat e barerave te keqija shumevjecare dhe pjeset e brendshme

te lastareve marrin ngjyre kafe. Nekrotizimi i plote i barerave te keqija gramore ndodh per 3-4 jave ne varesi te kushteve klimatike.

Fitotoksiciteti:

Nuk eshte fitotoksik kur perdoret sipas rekomandimeve te mesiperme. Mos mbillni te lashtat ose miser pa kaluar 2 muaj nga sperkatja. Evitoni perdorimin e tij ne toka shume ranore.

Ndikimi ne mjedis:

SP1 - Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij (Mos pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujit sipërfaqësor. Shmangni ndotjen përmes kanalizimeve nga kopshtet dhe rrugët).

Eshte relativisht jo-helmues per bletet dhe zogjte, por eshte helmues per peshqit dhe organizmat ujore. I rrezikshem per insektet e dobishme dhe i demshem per kafshet bujqesore e shtepiake. Mbani kafshet larg zones se sperkatur per 60 dite. Fluazifop-P-butil thithet nga koloidet e tokes, ndaj shpelarja e tij eshte e kufizuar dhe mundesia e ndotjes se ujerave nentokesor eshte e vogel. Koha e qendrimit ne toke eshte relativisht e vogel 1-2 muaj. Për të mbrojtur organizmat ujorë afër parces qe do të trajtohet respektoni një brez sigurie të pa trajtuar me gjërësi prej 5 m nga ujerat siperfaqesore.

Karenca:

Agrumet 1 jave; Pemet frutore, vreshti, ulliri, perimet 1 muaj; luledielli 6 jave; patatja, duhani, panxharsheqeri, fasulja, soja 8 jave; pambuku 10 jave.

Kushtet e ruajtjes dhe magazinimi:

Preparati ruhet ne kuti te mbyllura, ne vende te thata e te ftohta. Ne vendin e ruajtjes te mos kaloje temperatura me shume se 35 grade C. Preparati te mos mbahet ne diell e ne lageshti.

Numri dhe data e regjistrimit: 746, datë 4.12.2020;

Pesha neto: 250 ml, 0.5 l dhe 1l;

Nr serise: _____;

Data e prodhimit: _____;

Datën e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje: 3 vjet;

Prodhuesi: Sharda Cropchem Ltd. **Adresa:** Mumbai-Indi.

Emrin dhe adresën e aplikantit: Sharda Chropchem Espana SL. **Adresa:** Murcia, Spanjë.